



“DIPLO 2024”, HASANI: INSTRUMENT I DOBISHËM PËR AVANCIMIN E PRIORITETEVE

Pas 8 vitesh, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme organizoi Konferencën e Ambasadorëve “Diplo 2024”, e cila ofroi një mundësi për të paraqitur prioritetet që do të orientojnë punën e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të RSH në botë. Kryeministri Edi Rama dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani theksuan evolucionin e politikës së jashtme shqiptare në vitet e fundit, teksa nënvizuan edhe prioritetet dhe sfidat që e rrethojnë atë në vijim. Në panelin e parë të Konferencës “Rrugëtimi dhe dinamikat e procesit të integritimit në BE”, pjesë e së cilës ishte edhe Zëvendëskryeminstrija sllovene Tanja Fajon, u theksua nevoja për përshejtimin e procesit të integritimit të rajonit në BE.



ECURIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE ÇËSHTJET E SIGURISË, NË FOKUS TË DIPLOMACISË SHQIPTARE

Në panelin “Drejt 2030 - Shqipëria në Bashkimin Evropian”, panelistët analizuan efektivitetin dhe impaktin e diplomacisë shqiptare në procesin e integritimit, si dhe dhanë rekomandimet e tyre për mënyrat se si ajo të forcohet më tej. Ata diskutuan për rolin e rëndësishëm që Shqipëria ka luajtur në forcimin e partneritetit strategjik me BE-në dhe e vlerësuan momentin aktual si një mundësi të jashtëzakonshme për të maksimizuar përfitimet nga ky proces. Në panelin “Sfidat e reja të politikave të sigurisë, kufijtë e kërcënimeve kibernetike, keqinformimit dhe dezinformimit”, pjesëmarrësit analizuan mjetet dhe kapacitetet e Shqipërisë për të parandaluar këto kërcënime.



STABILITETI NË RAJON, SHQIPËRIA AKTORE PROAKTIVE DHE PROMOTORE E BASHKËPUNIMIT RAJONAL

Punimet e ditës së dytë të Konferencës së Ambasadorëve, nisën me panelin “Stabiliteti dhe sfidat aktuale në rajonin e Evropës Juglindore”. Pjesëmarrësit diskutuan rreth forcimit të rolit të Shqipërisë si nxitëse e bashkëpunimit rajonal dhe fqinjësisë së mirë. Në ditën e dytë të Konferencës së Ambasadorëve, MEPJ Igli Hasani, theksoi se shqiptarët në rajonin e Ballkanit Perëndimor janë faktorë dhe aktorë pro aktivë në hartimin dhe implementimin e politikave, si në rrafsh lokal ashtu dhe rajonal. Kryediplomati shqiptar Hasani u shpreh se MEPJ ka filluar një projekt serioz për të krijuar një departament i cili do të merret ekskluzivisht me shqiptarët në rajon.



“DIPLO 2024” FOKUS DIPLOMACISË EKONOMIKE, KULTURORE DHE TURIZMIT

Në ditën e dytë të Konferencës së Ambasadorëve “Diplo 2024”, u mbajtën një sërë panelesh me fokus në diplomacinë ekonomike, diplomacinë kulturore, turizmin etj. Në panelin me temë “Diplomacia dhe turizmi”, u diskutua rreth rolit të diplomacisë dhe turizmit si dy forca që kontribuojnë në promovimin e vlerave kombëtare dhe ndërtimin e imazhit të vendit në arenën ndërkombëtare. Në panelin kushtuar Diplomacisë Ekonomike u diskutua për rolin e rëndësishëm që ajo ka për identifikimin e strategjive që avancojnë zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, duke ndihmuar gjithashtu në avancimin e axhendës politike. Diskutimi mbi diplomacinë ekonomike përfshiu edhe njohjen me modele të suksesshme të vendeve të tjera, lidhur me përfshirjen e shërbimit diplomatik në nxitjen e investimeve dhe tregtisë. Dita e dytë e “Diplo 2024” u përmbyll me panelin kushtuar rëndësisë së diplomacisë kulturore në formësimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe. Paneli shërbeu si një platformë për ambasadorë, artistë dhe përfaqësues të diasporës për të ndarë përvojat e tyre të suksesshme dhe për të diskutuar mënyrat se si kultura mund të jetë një pjesë e fuqisë së butë të një kombi.



MINISTRI HASANI TAKON TANJA FAJON: ANËTARËSIMI NË BE, PRIORITETI YNË STRATEGJIK

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, ka zhvilluar një takim dypalësh me Zëvendëskryeminstren dhe Ministren e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Sllovenisë, Tanja Fajon. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Sllovenisë në rrugëtimin evropian të Shqipërisë, teksa theksoi se vendi ynë ka bërë përparim të vazhdueshëm në përmbushjen e standardeve të BE.



SHQIPËRIA GATI PËR MBAJTJEN E KONFERENCËS SË DYTË NDËRQEVERITARE SHQIPËRI-BE

Gjatë bashkëbisedimit me gazetarët, në përfundim të Konferencës së Ambasadorëve, MEPJ Igli Hasani theksoi se qeveria shqiptare është gati për Konferencën e dytë ndërqeveritare me BE. Ministri Hasani ritheksoi vëmendjen e shtuar të MEPJ për shqiptarët në rajon, përmes ngritjes së një drejtorie të re, e cila do të merret, angazhohet ekskluzivisht me gjithë shqiptarët që janë në rajon dhe me hartën dhe kompozimin e përfaqësive diplomatike nëpër botë. Ai gjithashtu njoftoi hapjen e ambasadave të reja në Indi, Indonezi dhe Kenia për të forcuar përfaqësimin diplomatik të Shqipërisë. Teksa dha detaje për samitet e ardhshme që pritet të mbahen në Tiranë, Ministri Hasani u shpreh se Shqipëria ndodhet në një momentum, i cili duhet shfrytëzuar maksimalisht.